



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI**

Nr. 6076 Prot

Shkodër, më 26.10.2022

VENDIM
Nr. 750, datë 26.10.2022

**"PËR
NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA SHKODËR ME PROCEDURË TË
THJESHTUAR"**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja "b", në nenin 26 të Ligjit Nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ", i ndryshuar; në nenin 11, dhe 12 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar; Kryetari i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Te ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a. Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore;
 - b. Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojnë dokumentin e Strategjisë Territoriale;
 - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mospërputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
 - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
 - e. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

2. Pjesë integrale e këtij vendimi është materiali i nismës
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Shkodër.
4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

KRYETARI

Bardh Spahia

